



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 11, Datë 23.01.2020

MBI

**KËRKESËN E SHOQATËS SHQIPTARE TË FURNIZUESVE TË ENERGJISË
ELEKTRIKE (AAES) PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE NR. 214,
DATË 20.12.2019, PËR NJË NDRYSHIM NË "RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E
SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBITIT
PUBLIK".**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 23.01.2020, trajtoi kërkesën e Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE Nr. 214, datë 20.12.2019, “Për një ndryshim në Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” dhe mbasi shqyrtoi relacionin nr. 19/5 Prot., datë 20.01.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Drejtoria e Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 15/1 Prot., datë 27.12.2019, protokolluar me tonën nr. 863 Prot., datë 30.12.2019, Shoqata Shqipëtare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), ka paraqitur në ERE kërkesën për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE Nr. 214, datë 20.12.2019, “Mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për një ndryshim në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjise elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.
- Në nenin 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, parashikohet se: “Për një Vendim të Bordit, Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të

vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi”.

- Kërkesa e shoqatës AAES, është depozituar brenda afateve të parashikuara në Rregulloren e sipërcituar.
- AAES ka paraqitur më herët komente lidhur me vendimin e ERE Nr. 123, datë 29.07.2019 "Për fillimin e procedurës për një ndryshim në Rregulloren e sipërcituar, ç'ka e legjitimon për të paraqitur këtë kërkesë për rishikim, si palë e përfshirë/interesuar, sipas parashikimeve të nenit 16, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016.
- AAES pretendon se gjatë shqyrtimit të argumentave të paraqitura nga OSHEE sh.a. në kuadrin e konsultimeve të zhvilluara si rezultat i vendimit të ERE-s nr. 123, datë 29.07.2019 "Për fillimin e procedurës për një ndryshim në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", OSHEE sh.a., nuk ka paraqitur asnjë analizë të kostove ose prova bindëse për të argumentuar që çmimi i blerjes së energjisë elektrike, për shkak të ndryshimit të afatit të pagesave, nuk ka pësuar ndryshime duke mos konsideruar përcaktimet ligjore apo teknike, të shprehura në vendimin e ERE-s Nr. 26, datë 28.02.2019, (Rrëzimi i kërkesës së OSHEE sh.a.).
- AAES gjithashtu pretendon se ERE, në kuadrin e vendimmarrjes së saj, nuk ka konsideruar rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës, transpozuar në Vendimin Nr. 659, datë 21.11.2019 "Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me miratimin e një ndryshimi në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", konkretisht:
 - *Shqyrtimin e procedurave të aplikimit për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike, konform parashikimeve dhe afateve të përcaktuara në pikën 1, neni 21 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s".*
- Në lidhje me sa më sipër, konstatohet se neni 21, pika 1 së cilës i referohet AK, lidhet me: përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin pasardhës..., pra një referencë e gabuar, konstatim ky i pranuar si i saktë edhe nga ana e AAES.
- ERE vlerëson se konkurrenca lidhet ngushtë me transparencën dhe aplikimin e rregullave të barabarta për të gjithë pjesëtarët në procedurat e blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluar. Aktualisht rregullorja e miratuar nga ERE për procedurat e blerjes së energjisë elektrike garanton transparencën dhe trajtimin e barabartë të kompanive tregtare që marrin pjesë në procedurat e shit/blerjes së energjisë elektrike në OSHEE sh.a.
- Nga monitorimet dhe verifikimet e kryera, rezulton se si në vitin 2017, në vitin 2018 dhe në periudhën Janar – Shtator 2019 (të dhënat të publikuara në faqen web zyrtare të ERE-s), numri i kompanive tregtare të cilat kanë furnizuar me energji elektrike OSHEE sh.a. nga tregu i parregulluar është mbi

10 të tilla. Në këto kushte vlerësohet se rregullorja e miratuar nga ERE për procedurat e blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE sh.a. ka garantuar konkurrencën.

- Në nenin 69, gërma “ë” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, parashikohet se Procedurat e prokurimit të energjisë elektrike miratohen nga ERE, pas propozimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
- Me vendimin Nr. 103/2016, është miratuar Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik.
- Objekti i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë procedurat e blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike nga operatori i sistemit të shpërndarjes, operatori i sistemit të transmetimit dhe çdo kompani tjetër e energjisë elektrike për të cilën janë vendosur detyrimet e shërbimit publik (PSO) nga kompanitë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike.
- Në kuptim të sa më sipër, siç argumentuar gjerësisht edhe në Vendimin e ERE-s nr. 214/2019 i cili kërkohet të rishikohet, është e qartë që përcaktimi i afateve të shlyerjes së pagesave, siç parashikuar në nenin 20 të rregullores, nuk lidhet thelbësisht me konceptin e rregullimit të procedurës.
- Ligji, në vetvete parashikon ngushtësisht detyrimin kryesor për përcaktimin e procedurave, me të cilat të kryhen transaksionet për qëllimet për të cilat është hartuar kjo rregullore.
- Ligjvënësi në nenin 19, gërma “I” të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, është kufizuar në përcaktimin e procedurave, duke vlerësuar këto të fundit si thelbësore për të garantuar transparencën, mbrojtjen e konkurrencës së ndershme, trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues të tregtarëve të energjisë elektrike, në këtë marrëdhënie.
- Në vlerësim të analizës së mësipërme dhe shpjegimeve të dhëna nga OSHEE sh.a, dhe të palëve të përfshira në këtë proces si dhe të ERE në lidhje me kërkesën për ndryshimin e nenit 20 të rregullores së miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 103/2016, parimet e mësipërme, të cituara edhe në nenin 2, pika 2 të kësaj rregulloreje, janë të mbrojtura dhe të garantuara për sa kohë, procedura, termat dhe afatet e prokurimit të energjisë për Pjesëtarët e Tregut të Ngarkuar me Detyrimin e Shërbimit Publik nga tregtarët në tregun e parregulluar është e njëjtë dhe transparente.
- Përfaqësuesi i AAES, në mbledhjen e Bordit të ERE, kërkoi vlerësimin si provë të re të dhënave të marra në adresat elektronike përkatëse të publikimeve të procedurave të blerjes së energjisë nga OSHEE sh.a. si dhe të dhëna të tjera që sipas kërkuesit lidhen me argumentimin që këto të dhëna provojnë ndryshimin në numrin e pjesëmarrësve dhe çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE sh.a.
- Sa më sipër, nuk është vlerësuar si një provë e re, pasi vendimmarrja e ERE Nr. 214, datë 20.12.2019, është bazuar në prezervimin e parimeve bazë që orienton ligji e që lidhen me transparencën dhe barazinë e procedurave të OSHEE sha në një treg të lirë, fakt ky i pranuar edhe nga kërkuesi i pranishëm në mbledhje.
- Sa i përket argumentave të shtjelluara nga kërkuesi, shoqata AAES, nuk rezulton që të jenë depozituar prova të reja, apo argumenta shtesë, të tilla që të çojnë ERE-n në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga ai Nr. 214, datë 20.12.2019 “Mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për një ndryshim në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të

transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së AAES për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 214, datë 20.12.2019 “Mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për një ndryshim në Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, si të pambështetur në prova të reja, të tilla që mund të çojnë Bordin e ERE në marrjen e një vendimi të ndryshëm.
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë kërkuuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI